



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 252/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Aleancës Kosova e Re (AKR), në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2014, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Aleancës Kosova e Re (AKR), në Prishtinë kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1000 (njëmijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi

**Arsyetim**

PZAP-i, më datë 08.11.2013 ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik AKR në Prishtinë, në të cilën theksohet se me datën 08 qershor 2014 para selisë qendrore të AKR-së në Prishtinë, aktivistet e PDK-së në ditën e zgjedhjeve kanë dalë në qytet me një traktor me flamuj të PDK-së duke përdorur fjalë fyese ndaj subjektit politik AKR. Me këtë rast parashtruesi i ankesës konsideron se është bërë shkelje e LZP-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi foto nga vendi i supozuar i ngjarjes.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me datë 08.06.2014 e informoi subjektin politik PDK, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik nga AKR dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë, deri më datë 09.06.2014 në ora 17.00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK në të cilën deklaroi se mjeti i cili la lëvizur me postera dhe flamuj të koalicionit të PDK-së, konkretisht të kandidatit Shaip Muja është veprim i bërë nga persona të pa autorizuar nga persona të paidentifikuar me qëllim të prishjes së imazhit të PDK-së. Më tutje në përgjigje në ankesë theksohet se PDK dhe kandidati i saj Shaip Muja distancohet nga veprimi i tillë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

Në fotografinë e ofruar si provë që gjendet në shkresat e lëndës shihet se si simpatizantët e PDK-së në ditën e zgjedhjeve me 08 qershor në qytetin e Prishtinës kanë dalë me mjetin-traktor me flamuj të subjektit politik PDK dhe me posterin e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke thyer heshtjen zgjedhore.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik PDK është përgjegjëse për veprimet e saja duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit dhe bërja fushatë në çfarëdo mënyre ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohe bërja fushatë në çfarëdo mënyre, veprime këto që e bëjnë përgjegjëse dhe kanë ndikuar në caktimin e lartësisë së gjobës së shqiptuar, në kuptim të nenit 36.1 pika a) dhe nenit 120 paragrafi 1 pika c), lidhur me nenin 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 252/2014 më datën 09.06.2014



#### ***Këshillë Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*